



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:219275

Datë: 18.11.2022

Numri i dokumentit: 03661936

PKR.nr.159/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për Krimet e Rënda, kryetarja e trupit gjykues Ajser Skenderi, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.G., nga fshati Javor, Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/I.nr.46/2022 të datës 20.10.2022, në shqyrtimin fillestar publik, në praninë e Prokurorit të Shtetit Genc Nixha dhe të akuzuarit, me datë 16.11.2022 shpalli dhe me datën 18.11.2022 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **SH.G.**, nga i ati, e ëma– e vajzërisë, i lindur mënë fshatinKK Suharekë ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal:

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 20.09.2021, rreth orës 15:00, në malin në afërsi të fshatit Javor, Komuna e Suharekës, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim armën në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, në atë mënyrë që në vendin e cekur është vërejtur se ka armën në dorë të cilën nuk e ka përdor e që më pas, pas kontrollimit të kryer nga ana e policisë ka dorëzuar armën - pistoletën VZOR-50 me nr. ser.C83996 me një karikator si dhe tetë(8) fishek të cal. 7.65, të cilat më pas janë konfiskuar nga ana e policisë.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 17, 38, 39, 43, 69, 70, 71, 72, në lidhje me nenin 366 par. 1 të KPRK-së, të akuzuarin e:

GJYKON

Me dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro të cilën dënim me gjobë konform nenit 43 paragrafi 2 të KPRK-së është i obliguar që ta paguajë në 3 këste mujore dhe

atë kësti i parë për pagesë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit ndërsa kësti vijues në afat prej 30 ditëve, pas pagimit të kështit paraprak.

Konform nenit 43 paragrafi 3 të KP nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën gjykata mund t ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim ashtu që njëzetë (20) euro gjobë do të llogaritet barabartë me një ditë burgim.

Konform nenit 366 paragrafi 3 të KP nga i akuzuari konfiskohet arma- pistoleta VZOR-50 me nr. ser.C83996 me një karikator si dhe tetë (8) fishek të cal. 7.65, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të njëjtat duhet të shkatërrohen.

Obligohet i akuzuari, që në emër të shpenzimeve gjyqësore – paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) euro si dhe të paguaj shumën pesëdhjetë (50) euro për programin për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për Krimet e Rënda, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr.46/22 të datës 20.10.2022, kundër të akuzuarit Sh.G., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar i akuzuari Sh.G., e ka pranuar fajësinë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së. Ndërsa për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, gjykata e ka veçuar procedurën penale dhe për këtë vepër penale është shpall jo kompetente.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka theksuar se duke u nisur nga fakti se i akuzuari Shefqet e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë e që ka të bëjë me armëmbajtje pa leje, unë propozoj që i njëjti duke u bazuar edhe në provat të tjera të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari Sh.G., ka theksuar se arma i është gjetur në shtëpi dhe se të njëjtën vet ia ka dorëzuar policisë, pendohet për veprën e kryer, thekson se është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, propozon gjykatës që t ia shqiptojë një dënim sa më të butë pasi që është i papunë-invalid i luftës e ka gjendjen e vështirë materiale, është mbajtës i vetëm i familjes, premtion se tani e tutje nuk do të bie në konflikt me ligjin.

Në bazë të pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provat materiale në të cilat bazohet aktakuza, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: me datë 20.09.2021, rreth orës 15:00, në malin në afërsi të fshatit Javor, Komuna e Suharekës, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim armën në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm, në atë mënyrë që në vendin e cekur është vërejtur se ka armën në dorë të cilën nuk e ka përdor e që më pas, pas kontrollimit të kryer nga ana e policisë ka dorëzuar armën- pistoletën VZOR-50 me nr. ser.C83996 me një karikator si dhe tetë(8) fishek të cal. 7.65, të cilat më pas janë konfiskuar nga ana e policisë..

Në bazë të të gjitha të cekurave më lartë, gjykata ka vërtetuar se me veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale e cila i vihen në barrë me aktakuzë.

Duke pasur parasysh se në shqyrtimin fillestar, me respektimin paraprak të të gjitha të drejtave ndaj të akuzuarit, i akuzuari vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, dhe se pranimi ka të bëjë me tërë përshkrimin e ngjarjes si në dispozitiv, nga i cili rrjedhin elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë.

Gjatë pranimit të fajësisë i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i njëjti, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik.

Sa i përket dënimit, gjykata të akuzuarin e gjykoi me dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë tek i akuzuari, do të arrihet efekti i sanksionit penal që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla inkriminuese dhe se një dënim i tillë i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale për të akuzuarin.

Me rastin e caktimit të dënimit, llojit dhe lartësisë së tij si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin, mori parasysh faktin se i njëjti vullnetarisht ka pranuar fajësinë si dhe gjendjen e tij të dobët ekonomike, rrethanat personale është baba i tre fëmijëve dhe mbajtës i familjes ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj gjykata ka vlerësuar se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që i akuzuari në të ardhmen të mos kryej ndonjë vepër të re penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u morë në kuptim të nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krimet e Rënda
Pkr.nr.159/2022, të datës 18.11.2022

B. profesional
Shqipron Sedolli

Kryetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi

UDHËZIM JURIDIKË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.